



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
**Komuna e Drenasit**  
Zyra e Kryetarit



Nr 01-400/01-52430 dt. 11/12/2025

Në bazë të nenit 58 paragrafi 1 pika (h) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kryetari i Komunës së Drenasit, propozon: që në bazë të nenit 12 dhe 40 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës"), nenit 7 të Ligjit Nr.04/L-076 për Policinë, nenit 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ Nr.27/2012 MPB-03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi, Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur me datë 17.12.2025, propozoi këtë

## P R O P O Z I M V E N D I M

### Për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi

#### Neni 1

Më këtë Propozim Vendim i propozohet Kuvendit të Komunës themelimi i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi në këtë përbërje:

Ramiz Lladrovci, Kryetari i Komunës (Kryesues),

- \_\_\_\_\_ Koordinatorë e KKSB-së,
- \_\_\_\_\_ Komandanti i Stacionit të Policisë në Drenas,
- \_\_\_\_\_ Përfaqësuesi i Bashkësisë Islame,
- \_\_\_\_\_ Përfaqësuesi i Komunitetit Katolik
- \_\_\_\_\_ Drejtor i Drejtorisë për Arsim,
- \_\_\_\_\_ Kryetari i Këshillit të Prindërve të Arsimit
- \_\_\_\_\_ një përfaqësues i FSK-së,
- \_\_\_\_\_ Ekipi Veprues për Siguri në Bashkësi,
- \_\_\_\_\_ Një përfaqësues nga Sektori i Emergjencave Civile Komunale,
- \_\_\_\_\_ Përfaqësuesi i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim,
- \_\_\_\_\_ Një përfaqësues nga OJQ-të.
- \_\_\_\_\_ Kryesuesi i Komitetit për Komunitete,
- \_\_\_\_\_ përfaqësues nga biznesi.
- \_\_\_\_\_ përfaqësues nga mediat lokale
- \_\_\_\_\_ përfaqësues nga kom. i personave me aftësi të kufizuara.
- \_\_\_\_\_ Përfaqësues nga Këshilli i veprimt Rinor Lokal (KVRL)

## **Neni 2**

Detyrat dhe Përgjegjësit e KKSBB-së janë të parapara me nenin 6 të Udhëzimit Administrativ Nr.27/2012 MPB-03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi.

## **Neni 3**

Mandati i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi është katër (4) vjeçar, ashtu sikurse anëtarët e Kuvendit, si dhe përfundon me përfundimin e mandatit të anëtarëve të kuvendit.

## **Neni 4**

Ky vendim hyn në fuqi nga dita e miratimit nga Kuvendi i Komunës dhe vlerësimi të ligjshmërisë nga ana e MAPL-së.

  
**Kryetari i Komunës**  
**Ramiz Lladrovci**

## ARSYETIM

Themelimi i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi është përcaktuar me nenit 7 të Ligjit Nr.04/L-076 për Policinë, nenit 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ Nr.27/2012 MPB-03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi.

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi themelohet dhe është përgjegjës për; përgatitja e planit vjetor të punës dhe zhvillimi i projekteve për rritjen dhe përmirësimin e sigurisë në bashkësi; identifikimi i dukurive negative që tentojnë të prishin sigurinë publike dhe rekomandojë planet e veprimi; bashkëpunimi me policinë në parandalimin e veprimeve të cilat e kërcënojnë sigurinë në bashkësi; bashkëpunimi me institucionet qendrore që merren me sigurinë publike, më qëllim të krijimit të një ambienti sa më të sigurt në bashkësi; lidhja marrëveshjeve të bashkëpunimit me KKSB-të e komunave fqinje për çështjet e sigurisë në bashkësi që i tejkalojnë kufijtë e komunës së tyre; të kërkojë nga Kuvendi Komunal i Komunës, financimin e projekteve të lidhura me sigurinë e bashkësisë; përmes komunës, të kërkojë nga ndonjë organizatë jo qeveritare financimin e projekteve të lidhura me sigurinë e bashkësisë; fton në takimet e tyre përfaqësuesit e MPB-së- DSB; fton përfaqësues nga institucionet qeveritare, të mediave ose përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile që të marrin pjesë në takime të KKSB-së; kërkon nga policia përgjigje për rastet që janë me rëndësi për sigurinë e bashkësisë, duke mos ndërhyrë në procesin e hetimeve policore; mbajtja e takimeve të rregullta, ashtu siç përcaktohet në nenin 11 të këtij udhëzimi administrativ.